

Gjendja e demokracisë shqiptare në prag të zgjedhjeve parlamentare 2013

PERCEPTIME 2013

Tiranë, 2013

Editor: **Albert Rakipi, PhD**

Shkrimi dhe analiza: **Alba Çela, Joana Kosho**

Përkthimi: **Andi Balla, Dhimiter Gjodede**

Redaktimi anglisht: **Elena Shomos**

Redaktimi shqip: **Emira Kokobobo**

Grafika: **Daniel Prifti**



Instituti i Studimeve Ndërkombëtare
Rr. Andon Zako Çajupi, No. 20/5
Tirana, Albania
Tel: +355 4 4400084 Fax: +355 4 4400085
e-mail: aiis@aiis-albania.org
url: www.aiis-albania.org



Falënderime

Ky studim u mundësua me mbështetjen financiare të Fondacionit Friedrich Ebert (FES) dhe të Agjencisë Austriake për Zhvillim (ADA).

Austrian

 Development Cooperation

HYRJE

Raundi i ardhshëm i zgjedhjeve parlamentare në Shqipëri, një cili do të mbahet më 23 qershor 2013, do të jetë testi përcaktues për demokracinë shqiptare, në një kontekst polarizimi të lartë dhe luhatje të stabilitetit. Zgjedhjet po vijnë pas një sërë procesesh të mëparshme zgjedhore, të cilat kanë qenë tepër të kontestuar dhe kanë shkaktuar disa kriza politike, bojkote dhe incidente të rënda. Nëse Shqipëria dështon edhe njëherë në zhvillimin e një procesi zgjedhjesh demokratike, me standarde të pranuar nga vëzhguesit ndërkombëtarë dhe me rezultatin e pranuar nga aktorët politikë të vendit, pasojat do të jenë serioze për një vend që është anëtar i NATO-s dhe aspiron statusin e kandidatit në BE.

Së pari, çka është më e rëndësishme, zgjedhjet do të jenë një faktor kyç për stabilitetin politik, një parakusht i mirëqenë për zhvillimin e Shqipërisë. Zgjedhjet do të kenë një rëndësi të jashtëzakonshme dhe domethënëse në një kohë kur Shqipëria po përpiqet t'i japë fund periudhës së tranzicionit dhe në kontekstin e integritimit evropian, i cili deri më tani është prekur thellësisht dhe negativisht nga lufta politike. "Përmbushja e standardeve për zgjedhje të lira dhe të drejta" është përcaktuar si një parakusht, si për statusin, ashtu dhe për

hapjen e negociatave.¹

Së dyti, zgjedhjet do të mbahen në një kontekst që karakterizohet nga ndërthurja e shumë faktorëve.

Skena politike në Shqipëri po popullohet me tematika dhe aktorë të rinj.²

Diskursi publik në Shqipëri po karakterizohet nga një rritje e paprecedent e temave nacionaliste, qasjeve dhe aktorëve që pretendojnë të kenë në krye të programit platforma që kanë të bëjnë “me çështjen kombëtare”, pavarësisht nga përcaktimi që i japin asaj. Mund të thuhet se ekziston një garë e ashpër për të mbizotëruar skenën mediatike për sa i përket tematikës nacionaliste. Kjo situatë po ndikon seriozisht mbi programet e medias. Çështjet e prezencës dhe konsolidimit të shtetit, demokracisë dhe qeverisjes po lihen mënjanë, për t’u dhënë hapësirë propozimeve nga aktorë të ndryshëm, propozime që nxisin reagime te forta, bashkë me pasojat që shkaktojnë. Për më tepër, situata po ndikon mbi rolin tradicional pozitiv që Shqipëria ka pasur deri më tani në rajon, si dhe në perceptimin e këtij roli nga komuniteti ndërkombëtar dhe për marrëdhëniet me fqinjët.

Nga ana tjetër, çka mund të quajmë një zhvillim pozitiv është fakti se fushata aktuale elektorale duket se ka sjellë për herë të parë, edhe pse vetëm pjesërisht, një diskutim real të ideologjisë dhe të alternativave për zhvillim, sa konkrete aq edhe të ndryshme, sidomos në sferën e ekonomisë, ku duket se alternativat fiskale mbizotërojnë debatin e fushatës. Sistemet e taksimit, shtysat e punësimit dhe modelet e ndryshme të zhvillimit po përmenden dhe debatohen këto ditë më shume se kurrë, duke na ofruar një bazë të pjesshme për profilizimin

1 Stefan Fule, Komisioneri i Zgjerimit të BE, mes të tjerash ka këmbëngulur shpeshherë se zgjedhjet parlamentare duhet të përmbushin standardet e larta në mënyrë që të fuqizohen objektivat e vendit drejt BE-së. Shih <http://www.balkaninsight.com/en/article/eu-reminds-albania-on-the-need-for-free-elections>

2 Kjo anketë u realizua në periudhën Shkurt-Mars 2013, disa javë përpara shpalljes së aleancës midis Partisë Socialiste dhe Lëvizjes Socialiste për Integrim, ndaj dhe efekti publik i prodhuar nga ky zhvillim politik i rëndësishëm nuk është pasqyruar në të dhënat e kësaj ankete.

ideologjik të partive të ndryshme.

Pavarësisht nga mbizotërimi i dy partive kryesore, Partisë Socialiste (PS) dhe Partisë Demokratike (PD), sistemi elektoral ka dhënë prova se arritja e rezultateve përfundimtare kërkon rolin e një personazhi të rëndësishëm si mjet për përcaktimin e një shumice qeverisëse. Ndaj edhe koalicionet para dhe pas zgjedhjeve janë tepër të rëndësishme për llogaritë politike. Këtë vit, ngjitja në skenë e partive të reja politike duhet të faktorizohet në pritshmëritë se kush do ta luajë rolin e personazhit të sipërpërmendur.

Aktorët e rinj, të cilët po bëhen gjithnjë e më të rëndësishëm në ndikimin që mund të ushtrojnë, nga sa mund të gjejnë në mbulimi i medias, përfshijnë Aleancën Kuq e Zi (AKZ), një forcë politike me platformë nacionaliste dhe Frymën e Re Demokratike (FRD), një grup i kahut të djathtë i përbërë kryesisht nga ish-pjesëtarë të Partisë Demokratike, të cilët udhëhiqen nga ish-Presidenti Bamir Topi. Gjithsesi, në kontekstin e sistemit elektoral edhe partitë e vogla aktuale fitojnë një rëndësi të re. Këtu përfshihen Partia e Bashkimit për të Drejtat e Njeriut (PBDNJ), e cila përfaqëson kryesisht minoritetin grek dhe Partia për Drejtësi, Integritim dhe Unitet (PDIU), e njohur ndryshe si partia e çamëve. Këto dy parti, po të marrim në konsideratë qëndrimin e tyre për sa i përket programeve nacionaliste, luajnë në kahe të kundërt. Por nuk mund të lihen mënjanë as disa parti të tjera të vogla, të cilat gjithsesi kanë pasur një marrëdhënie më të qëndrueshme me njërin nga dy partitë e mëdha, PD-në apo PS-në.³

Në rrafshin ekonomik, kriza ekonomike, që është akoma e pranishme në Evropë, nuk e ka kursyer Shqipërinë. Sipas

3 Për një tablo më të plotë të partive politike shqiptare shih Executive Briefing: Elections and political parties in Albania since 1991 raport i Tirana Center for Journalistic Excellence www.TCJE.ORG

Instituti Kombëtar të Statistikave (INSTAT), rritja ekonomike për këtë vit ka qenë më e ulëta që prej kolapsit financiar të viti 1997.⁴ Efekti i krizës në Italinë dhe Greqinë fqinje ka ndikuar negativisht mbi remitancat dhe eksportet, ndërkohë që papunësia mbetet një nga sfidat më të vështira për Shqipërinë.

Duke marrë parasysh këtë kontekst, Instituti i Studimeve Ndërkombëtare (ISN) e gjykoi të nevojshme të kryente një matje tërësore të pulsit të publikut në mënyrë që të përcaktonte, brenda kufijve të vendosur nga shkenca e statistikës, shqetësimet e vërteta të publikut shqiptar në prag të këtyre zgjedhjeve. Ky studim, i bazuar në një anketim në rang kombëtar, i shërben pikërisht synimit për të ekspozuar shqetësimet dhe pritshmëritë e vërteta të qytetarëve shqiptarë në prag të këtyre zgjedhjeve, vlerësimin që ata kanë mbi gjendjen e demokracisë, ekonomisë dhe shpresat e tyre në lidhje me parlamentin dhe qeverinë e ardhshme, pavarësisht se cilit kah do t'i përkasin këto dy institucione.

Ky projekt, i cili shkon përtej kureshtjes akademike, ka dy synime të rëndësishme. Së pari, projekti kërkon të tregojë sesa korrespondon retorika politike dhe mediatike me shqetësimet e vërteta qytetare, të projektuara në këtë anketim si një tërësi shqetësimesh, pritshmërish, besimesh dhe dëshirash. Së dyti, projekti përpiqet të ndërgjegjësojë partitë dhe aktorët politikë për nivelin e kësaj korrespondence, ose më saktë, siç do ta tregojë studimi, të kësaj mospërputhjeje. ISN beson se nxitja e diskursit publik lidhur me shqetësimet e vërteta të qytetarëve do të ketë një efekt pozitiv për një përputhje më të madhe të interesave të qytetarëve me platformat politike, duke dhënë një kontribut më të madh drejt demokracisë dhe një qeverisjeje më të mirë në të ardhmen.

⁴ Në 2012, PBB u rrit me 1.6% sipas INSTAT. Shih <http://www.top-channel.tv/artikull.php?id=254452>

PËRMBLEDHJE

Përballë sfondit të komplikuar politik, programeve, retorikës nacionaliste dhe koalicioneve të llogaritura, problemet e qytetarëve duken sa të zakonshme, aq edhe dramatike: shqetësimi për ekonominë dhe punësimin, ankthi në rritje mbi standardet demokratike, si dhe humbja gjithnjë e më e madhe e besimit ndaj shumë institucioneve në përgjithësi dhe sistemit të drejtësisë në veçanti.

GJITHMONË EKONOMIA

Çështjet ekonomike janë gjithmonë në krye të listës së interesit qytetar dhe pjesa më e madhe e të intervistuarve janë shprehur se problemi më i madh me të cilin po përballen aktualisht shqiptarët është kriza ekonomike. Në një nivel akoma më vetjak, qytetarët ndihen tepër të shqetësuar në lidhje me të ardhurat e tyre të pamjaftueshme, mungesën e përgjithshme të vendeve të punës dhe varfërinë.

Faktiqëçështjetekonomikendodhennëqendërtëshqetësimeve të qytetarëve në Shqipëri, nuk është ndonjë gjë për t'u çuditur. Ajo çka aktualisht i bën më akute shqetësimet ekonomike në

lidhje me mirëqenien, papunësinë dhe ardhshmërinë ekonomike është fakti se efektet e krizës ekonomike në Evropë po ndihen gjithnjë e më shumë edhe në Shqipëri.

Dy të tretat e qytetarëve shqiptarë, të intervistuar, e përshkruajnë situatën ekonomike në vend si të keqe ose shumë të keqe, të ndjekur nga 22 për qind të anketuarish, të cilët e shohin situatën ekonomike si mesatare dhe nga një grup i vogël prej 7 për qind, të cilët mendojnë se situata ekonomike është e mirë. Pothuajse askush nuk e percepton situatën ekonomike si shumë të mirë. Për sa i përket pritshmërisë në të ardhmen, 32 për qind e të anketuarve nuk presin ndryshime në ardhshmërinë ekonomike, 29 për qind mendojnë se do të ketë përmirësime, ndërsa 21 për qind presin që ekonomia të përkeqësohet. Përballë këtij realiteti, 61 për qind e shqiptarëve mendojnë se mund ta braktisin vendin nëse do t'u jepej kjo mundësi. Ky fakt nuk duhet interpretuar si një problem potencial i shqiptarëve që abuzojnë me mundësinë e udhëtimit pa viza. Në fakt, shqiptarët e kanë respektuar gjerësisht udhëtimin pa viza që nga viti 2011, me vetëm një pakicë fare të vogël që ka kërkuar azil. Kjo shifër që tregon dëshirën për të ikur lidhet kryesisht me një dëshirë për të përmirësuar gjendjen e tyre ekonomike dhe për t'i dhënë brezit të ri (fëmijëve të tyre) mundësi më të mira në jetë.

TË PAKËNAQUR ME CILËSINË E SHËRBIMEVE BAZË

Qytetarët nuk ndihen të kënaqur me cilësinë që iu ofrohet nga shërbimet publike bazë, të tilla si arsimi dhe shërbimi shëndetësor, por ekzistojnë dallime të lehta midis shërbimeve të ngjashme në sektorin publik dhe atë privat. Edhe pse shumica e qytetarëve e vlerësojnë mesatarisht arsimin e ofruar nga të dy sektorët, gjithsesi 49 për qind mendojnë se cilësia e arsimit privat është e dobët, në krahasim me 39 për qind që

kanë dhënë të njëjtin vlerësim për arsimin publik.

E kundërta ndodh me vlerësimin e shërbimit shëndetësor publik dhe atij privat, ku shumica (42 për qind) e qytetarëve është e mendimit se shërbimi privat ofron një cilësi më të lartë, ndërkohë që 65 për qind e të intervistuarve e gjykojnë shërbimin shëndetësor publik si të dobët ose shumë të dobët. Afërsisht një e treta e të intervistuarve e gjykojnë si mesatare cilësinë e të dy shërbimeve.

Vlerësime të rrepta ka marrë sistemi gjyqësor, i cili duket se përçmohet hapur nga pjesa dërrmuese e qytetarëve. 75 për qind e të intervistuarve besojnë se ky sistem nuk ofron drejtësi për shqiptarët. 67 për qind e qytetarëve besojnë se për të gjetur drejtësi në sistemin gjyqësor duhet patjetër të kesh lidhje me sistemin, qofshin këto lidhje personale apo politike. Përsëri, 75 për qind e të intervistuarve mendojnë se për të marrë drejtësi nga sistemi gjyqësor aktual në Shqipëri duhet paguar ryshfet.

Prirja mosbesuese kundrejt sistemit gjyqësor po bëhet një dukuri gjithnjë e më shqetësuese për opinionin publik dhe kjo nuk duket se po ndryshon, pavarësisht nga përpjekjet e shumta për ta reformuar sektorin në fjalë.

PRITSHMËRITË MBI PARLAMENTIN DHE QEVERINË E RE

Ndërsa shqetësimet kryesore të të anketuarve kanë të bëjnë me rrafshin ekonomik, edhe prioritetet kryesore të tyre në lidhje me qeverisjen e ardhshme pasqyrojnë të njëjtën natyrë me thelb ekonomik.

Shqiptarët besojnë se prioritetet kryesore për parlamentin

e ardhshëm shqiptar duhet të jenë “funksionimi i duhur i shtetit”, që kryeson me 26.3 për qind, “garantimi i vendeve të reja të punës dhe lufta kundër varfërisë” me 21.2 për qind të përgjigjeve të dhëna, si dhe funksionimi klasik i parlamentit “për të aprovuar legjislacionin dhe për të promovuar zbatimin e tij” me 13.1 për qind të përgjigjeve.

Vetëm 3.8 për qind e të intervistuarve presin që parlamenti i ri të ketë si prioritet bashkimin e të gjithë shqiptarëve në një shtet të vetëm, ndërkohë që 2.2 për qind përmendin bashkimin me Kosovën dhe 1.8 për qind kane si pritshmëri zgjidhjen e çështjes çame.

Kur janë pyetur mbi prioritetet e qeverise së re, shqiptarët kanë si prioritet aspektin ekonomik dhe përqendrohen mbi shërbimet. Sipas të intervistuarve, tre prioritet kryesore për qeverinë e re duhet të jenë “zhvillimi ekonomik dhe krijimi i vendeve të punës”, e cila përbën 28.8 për qind të përgjigjeve të dhëna, “rritja e standardeve në shërbimet publike si arsimi dhe shërbimi shëndetësor” me 17.8 për qind të përgjigjeve dhe kemi një barasvlerësim të nevojës për “punësimin e të rinjve” dhe “luftën kundër varfërisë, me përkatësisht 16.5 dhe 16.4 për qind të përgjigjeve.

Çështjet e programeve nacionaliste në lidhje me qeverinë e re përmenden vetëm nga 2.2 për qind e të intervistuarve, të cilët kanë zgjedhur bashkimin me Kosovën si prioritet, kurse 1.8 për qind e të anketuarve mendojnë si prioritet mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve që jetojnë jashtë kufijve zyrtarë të Shqipërisë.

PROGRAMI NACIONALIST I SHPËRFILLUR

Megjithëse shumica e partive politike, në mos të gjitha, kanë futur në masë të ndryshme çështje të karakterit nacionalist, duket se ato nuk kanë arritur dot t'u japin këtyre çështjeve një vend të rëndësishëm në problemet e qytetarëve. Edhe pse të gjithë politikanët përpiqen të jenë brenda nga pikëpamja patriotike, debatet që merren me të ardhmen e shqiptarëve në rajon apo me problemet e pazgjidhura midis Shqipërisë dhe Greqisë janë anësore në shqetësimet e qytetarëve. Në vështrim të parë duket disi kontradiktore që vetëm rreth 2 për qind e shqiptarëve shpresojnë që parlamenti i ri apo qeveria e re të bashkojë Shqipërinë me Kosovën, kurse kur vjen puna për të votuar në një referendum aktual për këtë bashkim, mbështetja shkon mbi 50 për qind. Megjithatë, ky fakt mund të shpjegohet kryesisht me shkallën e lartë të konformizmit dhe dëshirës, që shqiptarët të jenë në rregull nga pikëpamja patriotike.

Të dyja përgjigjet e mësipërme nënvizojnë faktin se shqiptarët kanë prioritet pragmatike, në dallim nga ato nacionaliste dhe se interesat e tyre janë të përqendruara në masat për zhvillimin ekonomik, luftën kundër varfërisë dhe hapjen e vendeve të reja të punës. Shumë pak qytetarë duken se kërkojnë që legjislativi dhe ekzekutivi i ri të ndërmarrin projekte nacionaliste të çfarëdo lloji.

DEMOKRACIA DHE ZGJEDHJET

Në këto zgjedhje pritet që pjesëmarrja në votime të jetë e lartë. 71 për qind e të intervistuarve janë shprehur se do të votojnë më 23 qershor dhe 76 për qind kanë deklaruar se kanë votuar në zgjedhjet e fundit vendore. Një grup i vogël qytetarësh mendojnë se nuk do të votojnë dhe pjesa dërrmuese e tyre e shpjegon këtë vendim me faktin se nuk besojnë se zgjedhjet do të jenë të lira dhe të ndershme ose sepse besojnë se vota e tyre

nuk ka rëndësi dhe nuk do sjellë ndryshim.

Në fakt, 42 për qind e shqiptarëve nuk besojnë se këto zgjedhje do jenë të lira dhe të ndershme, ndërkohë që vetëm 30 për qind mendojnë se këto standarde do të përmbushen. Shumë qytetarë ngelen konfuzë në lidhje me atë çka mund të presin nga standardet e procesit zgjedhor, ndaj dhe afërsisht 25 për qind e të intervistuarve nuk i kanë dhënë përgjigje kësaj pyetjeje.

Qytetarët duken të justifikuar në dyshimet e tyre rreth standardeve të zgjedhjeve. Së pari, përvojat e të kaluarës kanë zbuluar gjithmonë një sërë problemesh me administrimin e zgjedhjeve. Së dyti, debatet e komunitetit ndërkombëtar janë fokusuar shumë herë në rëndësinë e zgjedhjeve të lira e të ndershme, kurse çështjet që janë ngritur vazhdimisht nga ambasadorët dhe përfaqësuesit e trupit diplomatik në Shqipëri kanë krijuar një atmosferë ku duket sikur do të ketë probleme dhe nxitin për t'i shmangur ato.

Sipas qytetarëve, aktorët më të rëndësishëm për mbajtjen e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme janë: Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ), Komisionet Zonale të Administrimit Zgjedhor (KZAZ-të) dhe vëzhguesit e huaj. Pothuajse 70 për qind e pjesëmarrësve në anketë piketuan këta aktorë si faktorët më të rëndësishëm në procesin zgjedhor.

Këtu ekziston një tendencë për t'i dhënë një rëndësi më të madhe strukturës së drejtpërdrejtë të administrimit të zgjedhjeve dhe komunitetit ndërkombëtar. Aktorët vendorë, si pastitë politike, opozita, qytetarët dhe media, shihen po ashtu si kryesorë në këtë proces, megjithëse në një rang më të ulët se ata që u përmendën më sipër.

Sipas shumicës së shqiptarëve, shumë prej çështjeve të

një rëndësie madhore në Shqipëri nuk po ecin në rrugën e duhur. 51 për qind e qytetarëve besojnë se në përgjithësi vendi nuk po ecën në drejtimin e duhur. 55 për qind mendojnë se demokracia ka marrë rrugën e gabuar dhe një përqindje akoma më e madhe është tepër e shqetësuar me situatën ekonomike, ku 65 për qind e shqiptarëve u shprehën se ekonomia kërkon një strategji të re. Një e dhjeta e qytetarëve ishin të pavendosur dhe nuk zgjodhën një përgjigje.

60 për qind e shqiptarëve besojnë se jetojnë në një vend jodemokratik, me një ndarje pothuajse të barabartë mes pesimistëve, të cilët besojnë se Shqipëria nuk është aspak demokratike, dhe të moderuarve, të cilët mendojnë se ka disa elemente demokratike, por Shqipëria ngelet gjithsesi një vend jodemokratik. Vlerësimi në fjalë pasqyron një përkeqësim nga viti i kaluar dhe një ankth në rritje mbi gjendjen e demokracisë në vend.

Sfidat kryesore me të cilat po përballlet demokracia shqiptare, të renditura sipas rëndësisë nga shqiptarët, janë: mungesa e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme (një e treta e të intervistuarve); konflikti politik (një e katërta e të intervistuarve); mungesa e ndryshimit të udhëheqjes në partitë politike dhe pabarazia e theksuar ekonomike në popullsi (të dyja këto sfida u zgjodhën nga 13 për qind e qytetarëve).

Tre faktorët më të rëndësishëm për demokracinë shqiptare janë: qeveria, udhëheqja politike dhe qytetarët. 14 për qind e të intervistuarve beson se faktori më i rëndësishëm për demokracinë është komuniteti ndërkombëtar.

BESIMI NË INSTITUCIONE

Në një konfirmimin të anketave të mëparshme, niveli i besimit që shqiptaret kanë për institucionet dhe përfaqësuesit e tyre është i ulët. Entitetet ndaj të cilave shqiptarët kanë nivelin më të lartë të mosbesimit janë: partitë politike, gjykatat dhe kryeministri, të pasuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe qeveria.

Nivele të larta mosbesimi gjejmë edhe ndaj Zyrës së Presidentit. Mosbesimi, edhe pse në nivele disi më të ulëta, ekziston edhe ndaj opozitës, Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm dhe institucioneve fetare.

Ata që gëzojnë nivelet më të larta të besimit janë media, shoqëria civile dhe policia, ku media është entiteti që pasqyron nivelin më të lartë dhe më domethënës të besimit nga të gjithë aktorët e tjerë.

Nivele të ulëta të besimit horizontal dhe besimit në institucione përbëjnë një dukuri që shumë anketa e konfirmojnë për Shqipërinë dhe të cilat, të marra së bashku me varësinë e lartë të lidhjet vetjake dhe fisnore, shpeshherë e sabotojnë funksionimin e shtetit nga brenda tij.⁵ Qytetarët reagojnë negativisht mbi paaftësinë e institucioneve për të funksionuar në mënyrë profesionale, të paanshme dhe efektive.

POLITIKA E JASHTME RAJONALE

Gjysma e shqiptarëve besojnë se ekziston gjithmonë një vend i huaj me ndikimin më të madh mbi Shqipërinë. Për

5 Për shembull, një ankete kombëtare me të rinjtë, e zhvilluar nga Friedrich Ebert Stiftung Albania, tregon se të rinjtë kanë besim vetëm te familjet e tyre dhe varen në marrëdhëniet vetjake për të siguruar punë. "Zëri i të rinjve shqiptarë" FES, TIRANA: 2011.

pjesën dërrmuese të të intervistuarve ky vend kanë qenë Shtetet e Bashkuara të Amerikës (80 për qind e atyre që piketuan një vend me ndikim). Vetëm 7 për qind e atyre që shohin një ndikim të jashtëm kanë zgjedhur Bashkimin Evropian, ndërkohë që 22 për qind e qytetarëve nuk shohin asnjë ndikim madhor të jashtëm mbi Shqipërinë.

Një e treta e të intervistuarve beson se ekziston një vend që përbën kërcënim për Shqipërinë, ku gjysma e këtij grupi kanë piketuar Greqinë si kërcënimin më serioz dhe 22 për qind e tyre kanë zgjedhur Serbinë. 37 për qind e qytetarëve nuk identifikojnë asnjë vend si kërcënim të drejtpërdrejtë për vendin, ndërsa një e treta e të anketuarve nuk i janë përgjigjur pyetjes.

Shumica e qytetarëve besojnë se Shqipëria duhet t'i përqendrojë përpjekjet e saj për të forcuar bashkëpunimin me Kosovën dhe Turqinë, të ndjekur nga grupe mesatare të cilat shohin përfitime në bashkëpunime me vende të tjera në rajon. 2 vendet, bashkëpunimi me të cilat është gjykuar si më pak i nevojshëm nga të intervistuarit, janë Serbia dhe Bosnja-Hercegovina.

Gjysma e qytetarëve besojnë se bashkimi i Shqipërisë me Kosovën do të ishte një zhvillim pozitiv. 29 për qind i shohin pasojat/përfitimet e këtij bashkimi si të papërfillshme dhe 10 për qind mendojnë se ky bashkim do të kishte pasoja negative. Në një referendum të mundshëm, 55 për qind e shqiptarëve do të votonin pro bashkimit, 16 për qind nuk do të votonin dhe 14 për qind do të votonin kundër.


Është interesante të vihet re se kur vjen puna e një referendumi për bashkimin midis dy vendeve, qytetarët votojnë në përputhje me vijën patriotike. Megjithatë, për momentin e tanishëm, bashkimi apo për çështje të tjera nacionaliste, në

listën e përparësive të shqiptarëve radhiten poshtë, siç u duk kjo edhe në rezultatet që u treguan më sipër rreth përparësive të sugjeruara për ekzekutivin dhe legjislativin e ardhshëm.

GJETJET DHE ANALIZA


SHQETËSIMET NË PRAG TË ZGJEDHJEVE

Shqiptarët besojnë se problem më i madh me të cilin ata po përballen sot është kriza ekonomike. Perceptimi i qytetarëve përputhet mjaft mirë me realitetin. Nivelet e pritshme të rritjes ekonomike janë ripërcaktuar në nivele më të ulëta edhe nga qeveria në Shqipëri. Ndikimi që kriza ekonomike evropiane ka pasur mbi vendet fqinje si Greqia dhe Italia, është reflektuar në



mënyrë të drejtpërdrejtë në Shqipëri, me rënien e remitancave, tregtisë dhe kthimin e emigrantëve veçanërisht nga fqinji jugor.

Një e treta e grupit të të anketuarve ka vendosur krizën si shqetësimi i tyre kryesor, pasuar nga një përqindje të cilët besojnë se problem më i madh është mungesa e shtetit të së drejtës. Tre problemet pasuese të cilat kanë marrë një të dhjetën e përgjigjeve të të anketuarve janë korrupsioni, konflikti politik dhe keqqeverisja. 7% e qytetarëve sjellin problemin e mungesës së zgjedhjeve të lira e të ndershme, ndërsa grupe shumë të vogla, prej 3% secili, përmendin ngadalësimin e procesit të integritetit dhe nivelin e krimit.




Të pyetur në një nivel më personal mbi atë çka i shqetëson më tepër në jetën e përditshme, shumica e shqiptarëve përmendin një nivel të papërshtatshëm të ardhurash. 28% thonë se problemi i tyre më i madh janë të ardhurat e pamjaftueshme ekonomike, pasuar afër nga 25% të cilët thonë se problemi i tyre është papunësia. Një rezultat edhe më dramatik është ai i njerëzve që përmendin varfërinë e plotë si shqetësimin e tyre, të cilët janë 13%, pra, më shumë se një e dhjeta e kampionit. Rritja e nivelit të krimeve është pasqyruar gjithashtu në shifra


në analizën e qytetarëve me 9% të cilët e përmendin këtë si shqetësimin primar personal të tyre. Siguria në punë përbën shqetësim për 8% të të anketuarve ndërsa grupe më të vogla prej 4% secili janë të shqetësuar personalisht nga arsimi dhe kujdesi shëndetësor.

SHQETËSIME EKONOMIKE


Shumica e shqiptarëve, 45% e të anketuarve tanë, i përshkruajnë standardet e tyre aktuale të jetës si mesatare, pasuar nga 24% të cilët thonë se jetojnë në kushte të këqija. Grupe më të vogla prej 21% raportojnë kushte të mira ose shumë të mira ndërsa 9% thonë se jetojnë në kushte shumë të këqija.




Të pyetur mbi vlerësimin e gjendjes ekonomike aktuale të vendit, shumica e shqiptarëve janë pesimistë me 42% të cilët thonë se është keq, pasuar nga 24% të cilët thonë se është shumë keq. 22% e përshkruajnë ekonominë si mesatare ndërsa numri i atyre që e vlerësojnë mirë është nën 10%.



Shumica e njerëzve, rreth 32%, nuk presin ndryshime në situatën e tyre financiare në vitet e ardhshme. Një grup i konsiderueshëm prej 29% është optimist dhe ka pritje pozitive që do të përmirësohet, gjithsesi 21% presin që situatë të përkeqësohet. Është i rëndësishëm fakti që 18% duken të pasigurt se çfarë do të ndodhë, duke mos pranuar të përgjigjen ose duke mos pasur një përgjigje për këtë pyetje.



Krahasuar me pritshmëritë e tyre afatshkurtra, shqiptarët janë më tepër optimistë për pritshmëritë e tyre afatgjata. Vitin e kaluar më shumë se gjysma e të anketuarve u përgjigjën se në dekadën e ardhshme ata presin që kushtet e tyre të jetës (për ta dhe familjet e tyre) të përmirësohen.⁶



Me këtë në mendje, një shumicë e qytetarëve shqiptarë, 61 % do ta linin vendin nëse do ta kishin mundësinë për ta bërë këtë dhe vetëm 28% thanë se nuk do ta linin vendin. 11% ishin të pavendosur mbi këtë pyetje. Ka një pajtim në dëshirën për tu larguar edhe me sondazhe të kaluara, dëshmuar edhe nga një studim i AIIS vitin e kaluar kur 58% e qytetarëve konfirmuan se ata do të largoheshin nëse do t'iu jepej mundësia, kurse 35% thanë se do të zgjidhnin të qëndronin.⁷


SHËRBIMET PUBLIKE DHE PRIVATE

Përgjigjet e qytetarëve përshkruajnë një panoramë interesante vlerësimesh kur është fjala për cilësinë e shërbimeve publike


⁶ "Shqipëria në dhjetë vitet e ardhshme: Politika, Ekonomia, Shoqëria dhe Perceptimet", AIIS: 2012, fq 24.

⁷ "Shqipëria në dhjetë vitet e ardhshme: Politika, Ekonomia, Shoqëria dhe Perceptimet", AIIS: 2012, fq 44.


kundrejt atyre private. Të pyetur për cilësinë e arsimit publik në Shqipëri 47% besojnë se ai është mesatar, e njëjta gjë me cilësinë e arsimit privat i cili është përsëri mesatar për 30%. Në mënyrë të ngjashme 13 % e qytetarëve besojnë se arsimi publik ofron një cilësi të mirë krahasuar me 17% e qytetarëve që kanë të njëjtën konsideratë për arsimin privat. Gjithsesi 49% e qytetarëve besojnë se arsimi privat ofron cilësi të ulët ose shumë të ulët krahasuar me 39% e qytetarëve që thonë të njëjtën gjë për arsimin publik. Pra, si konkluzion, kur është fjala për arsimin, opinioni i përgjithshëm është se ajo çka ofrohet në Shqipëri ka cilësi mesatare, por se sektori publik ende po bën punë më të mirë se ai privat.




Një panoramë krejt e ndryshme jepet nga përgjigjet e qytetarëve kur bëhet fjalë për shërbimet shëndetësore, sepse numrat përmbysen. Këtë herë një cilësi më e lartë mendohet për sektorin privat në krahasim me atë shtetëror. Një shumicë prej 65 % shprehen se kujdesi shëndetësor publik është i një cilësie të ulët ose shumë të ulët ndërsa vetëm ¼ e kampionit e cilësojnë atë me një nivel mesatar. Një pakicë prej më pak se 10 % e vlerësojnë kujdesin shëndetësor publik me një cilësi të mirë. Kur bëhet fjalë për sektorin privat në shëndetësi ka disa sektorë,



megjithëse qytetarët besojnë se ata ofrojnë një cilësi të mirë ose shumë të mirë, janë 42% e tyre që e mendojnë kështu të ndjekur nga 1/3 e kampionit që e cilësojnë atë më një cilësi mesatare. Vetëm 16 % e personave të anketuar besojnë se shërbimi shëndetësor privat ofron shërbime të një cilësie të ulët.






AKSESI NË DREJTËSI

Pothuajse $\frac{3}{4}$ e shqiptarëve nuk besojnë se sistemi i tyre i drejtësisë jep drejtësi. 75% e të anketuarve besojnë se për të marrë drejtësi qytetarët duhet të mbështeten te korrupsioni, pagesa e kuotave për aktorët e punësuar në gjykata. Për më tepër, një numër i njëjtë prej 67 për qind i qytetarëve thonë se për të marrë drejtësi duhet ose të kesh lidhje personale, ose lidhje politike në mënyrë që të përfitosh prej tyre. Afërsisht 1 në 10 prej të intervistuarve refuzojnë të japin një opinion për këtë çështje.

Si rezultat, 73 për qind e shqiptarëve arrijnë në përfundimin se sistemi gjyqësor në Shqipëri nuk e ushtron funksionin e tij kryesor për të dhënë drejtësi. Kriza e besimit të qytetarëve lidhur me gjyqësorin po shndërrohet në një nga zhvillimet negative në Shqipëri. Pavarësisht nga përpjekjet për ta reformuar sistemin, ligjërisht apo nga ana e strukturës, si dhe nga ndihme e konsiderueshme që jepet nga jashtë për këtë sektor, gjykatat krijojnë një ndjenjë përçmimi te qytetari i thjeshtë Shqiptar.




PRIORITETET PËR LEGJISLATIVIN DHE EKZEKUTIVIN E ARDHSHËM

Qytetarët u pyetën të vendosnin prioritetet për parlamentin dhe qeverinë që do të vijjnë pas zgjedhjeve të 23 qershorit. Këto ishin midis pyetjeve më të rëndësishme duke qenë se synonin të gjykonin se çfarë renditet më lart në shqetësimet e qytetarëve.

Shqiptarët besojnë se prioritetet kryesore për parlamentin e ardhshëm shqiptar duhet të jenë: “funksionimi i mirë i shtetit” me pikët më të larta prej 26.3% të përgjigjeve të dhëna; “garantimi i mundësive për vende të reja pune dhe luftimi i varfërisë” me 21.2% të të gjitha përgjigjeve sikurse edhe “funksioni klasik tradicional i parlamentit që të aprovojë legjislacionin dhe të promovojë zbatimin e tij” me 13.1% të përgjigjeve. 10.6% e përgjigjeve identifikojnë garantimin e një sistemi gjyqësor funksional, 9.1% janë të shqetësuar për anëtarësinë e Shqipërisë në BE dhe 7.9% identifikojnë zgjidhjen përfundimtare të çështjeve të varfërisë si një prioritet i domosdoshëm. Përsheptimi i procesit të integritetit përbën 6% të përgjigjeve.

Një përfundim interesant është parë kur të dhënat e marra vetëm nga grupmosha 18-29 vjeç janë analizuar për prioritetet e parlamentit të ardhshëm. Për këtë grupmoshë prioriteti i parë i parlamentit duhet të jetë hapja e vendeve të reja të punës dhe luftimi i varfërisë, pasuar nga funksionimi i mirë i shtetit. Grupi i të rinjve, ashtu si e gjithë popullsia në tërësi, priret t'i japë rëndësi të vogël qëllimeve të çështjeve nacionaliste. Kështu, 5% e të rinjve të anketuar thanë se prioritet duhet të jetë unifikimi i të gjithë shqiptarëve në një shtet dhe më pak se 2.5% thanë se bashkimi me Kosovën duhet të jetë në listën e detyrave.


Pak qytetarë presin që parlamenti të ndërmarrë ndonjë përpjekje nacionaliste. Vetëm 3.8% e të anketuarve presin që parlamenti të ketë prioritet unifikimin e gjithë shqiptarëve në një shtet të vetëm ndërsa 2.2% përmendin bashkimin me Kosovën dhe 1.8% shohin zgjidhjen e çështjes çame si prioritet.



Kur u pyetën për prioritetet e qeverisë së re, të anketuarit u përgjigjën se i japin më shumë prioritet aspektit ekonomik dhe përqendrohen te shërbimet. Tri prioritetet kryesore për qeverinë e re sipas të anketuarve duhet të jenë “zhvillimi ekonomik dhe krijimi i vendeve të reja të punës” e cila përbën 28.8% të përgjigjeve të dhëna, “rritja e standardeve në shërbimet publike si arsimi dhe kujdesi shëndetësor” me 17.8% të përgjigjeve

dhe një shkallë pothuajse të barabartë midis punësimit të të rinjve dhe luftës kundër varfërisë respektivisht 16.5 % dhe 16.4%. Këto ndiqen nga grupe më të vogla të qytetarëve të cilët kërkojnë që prioritete të qeverisë të jenë: përsheptimi i integritetit evropian (7.5%), investimet në infrastrukturë (4.9%) dhe zhvillimi i turizmit (3.5%).

Edhe njëherë problemet nacionaliste përmenden rrallë, me më pak se 3% të të anketuarve në çdo rast. Ndërkaq vetëm 2.2 % përmendin bashkimin e Shqipërisë me Kosovën si një prioritet ndërsa 1.8% flasin për mbrojtjen e Shqiptarëve që jetojnë jashtë kufijve të Shqipërisë në vendet fqinje.




Duke marrë të dyja këto pyetje në konsideratë, mund të vihet re se shqiptarët janë shumë më tepër pragmatistë, realistë dhe të fokusuar në mirëqenien e tyre sesa në çështje që lidhen me nacionalizmin. Zhvillimi ekonomik, punësimi dhe luftimi i varfërisë janë përgjigjet më të zakonit të përmendura ku shqetësimi për cilësinë e shërbimeve është ende prezent si një prioritet i dëshiruar për qeverinë e ardhshme. Funksionimi i shtetit duket se është ajo çka shumica e shqiptarëve kërkojnë nga parlamenti i ardhshëm.

Për sa i përket nëngrupit të moshës 18-29 vjeç, kemi një kapërcim midis prioriteteve 2 dhe 3, ku punësimi i të rinjve vjen menjëherë pas “zhvillimit ekonomik” dhe “ritja e cilësisë së shërbimeve” vjen e treta në listën e prioriteteve. Përndryshe,


prirjet në zgjedhjen dhe renditjen e prioriteteve të grupit të ri të përputhen me ato të shfaqura nga kampioni me çështjet nacionaliste në fund të listës.

ZGJEDHJET


Shqiptarët duket se ka të ngjarë të kenë një pjesëmarrje të kënaqshme në këto zgjedhje. Shumica e të anketuarve ose 77% raportojnë se kanë marrë pjesë në votimet e fundit dhe vetëm një pakicë prej 21% thanë se nuk kanë votuar. Sërish, të pyetur nëse do të marrin pjesë në votimet e 23 qershorit, një shumicë prej 78% e konfirmuan, ndërsa 18 % thanë se nuk do të votojnë. Një e dhjeta e kampionit duket se nuk e kanë vendosur ende nëse do të votojnë apo jo. Nga ata të cilët u përgjigjën se nuk do të votojnë, arsyet e cituara më shpesh ishin se ata nuk mendojnë se vota e tyre do të ndryshojë ndonjë gjë (39% e atyre që nuk do të votojnë) dhe se ata nuk mendojnë që zgjedhjet do të jenë të lira e të ndershme (sërish 39% e atyre që nuk do të votojnë.)



A do të votoni në zgjedhjet e ardhshme parlamentare?




Përse nuk do të votoni në zgjedhjet e ardhshme parlamentare?



Shqiptarët mbeten të shqetësuar dhe pesimistë për standardet e zgjedhjeve të ardhshme. 42% thonë se ata nuk besojnë se këto zgjedhje do të jenë të lira e të ndershme ndërsa vetëm 30% kanë besimin se do të jenë të lira e të ndershme. Një numër i madh njerëzish, 28% nuk e dinë ose refuzojnë t'i përgjigjen kësaj pyetjeje duke sinjalizuar një shkallë pasigurie.

A mendoni se zgjedhjet e ardhshme parlamentare do të jenë të lira dhe të ndershme?



Sipas renditjes së rëndësisë së aktorëve të ndryshëm dhe institucioneve në zhvillimin e zgjedhjeve në Shqipëri, të anketuarit i japin një vlerë të madhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe komisionarëve vendorë të numërimit, pasuar nga roli i qeverisë dhe ai i vëzhguesve të huaj dhe i ambasadorëve të huaj. 70 % e qytetarëve besojnë se të dyja, si KQZ ashtu edhe komisionarët vendorë të numërimit, kanë një rëndësi të konsiderueshme ose maksimale për zgjedhjet. Pothuajse e njëjta shifër, 70% i jep rëndësi të madhe për procesin zgjedhor vëzhguesve të huaj, kryesisht misionet e OSBE/ODHIR-it. Ndërsa 62% i japin të njëjtën rëndësi qeverisë, një shifër e ngjashme prej 60% beson se ambasadorët e huaj kanë gjithashtu një rëndësi të madhe në lidhje me procesin zgjedhor. Aktorë të brendshëm si qytetarët, opozita dhe vëzhguesit vendorë janë konsideruar si shumë të rëndësishëm nga 57-59 % ndërsa aktorë të tjerë të brendshëm si media dhe shoqëria civile janë konsideruar gjithashtu të rëndësishëm nga pothuajse gjysma e të anketuarve. Është interesante të vëmë re se kur u pyetën për qytetarët, qeverinë, opozitën dhe shoqërinë civile, çereku i kampionit në secilin rast i jep pak ose aspak rëndësi atyre në procesin zgjedhor.

	1-2 Zero ose pak rëndësi	3 Rëndësi mesatare	4-5 Rëndësi e lartë/ maksimale
Qytetarët	24.2%	18.3%	57.5%
Partitë politike	23.4%	18.9%	57.7 %
KQZ	18.2 %	11.9%	69.9%
Komisionarë vendorë të numërimit	15.9%	14.7%	69.5%
Shoqëria Civile	26.5%	25.9%	47.7%
Media	23.2%	26.1%	50.7%
Vëzhgues vendorë	20.8%	20.4%	58.9%
Vëzhgues të huaj (OSBE/ODIHR)	15.4%	15.3%	69.3 %
Komuniteti Ndërkombëtar (delegacioni i BE, Ambasada Amerikane, ambasadorë të BE-së)	13.4%	16.0%	60.6%
Opozita	25%	17.8%	57.3
Qeveria	24.4%	13.2%	62.3%


VLERËSIME TË PËRGJITHSHME

Shqiptarët kanë vlerësime relativisht konstante negative për sa i përket pyetjes nëse vendi tyre po lëviz në drejtimin e duhur. Një shumicë prej 51% i është përgjigjur jo ndërsa 35 për qind kanë thënë po. Një përqindje e konsiderueshme prej 13% ishin të pavendosur ose refuzuan t'i përgjigjeshin kësaj pyetje. Numrat reflektojnë të njëjtat përgjigje të dhëna për pyetjen një vit më parë kur 56% e qytetarëve thanë përsëri se vendi po lëvizte në drejtimin e gabuar, krahasuar me 32 për qind të cilët thanë së ishte në drejtimin e duhur.⁸


E njëjta sjellje reflektohet në vlerësimin e qytetarëve për sa i përket demokracisë në Shqipëri. 55 për qind të atyre që janë përgjigjur besojnë se demokracia është në rrugën e gabuar, ndërsa 1/3 e kampionit beson se është në rrugën e duhur. 12 për qind e qytetarëve janë ose të pavendosur, ose refuzojnë të përgjigjen.

⁸ Shqipëria në dhjetë vitet e ardhshme: Politika, Ekonomia, Shoqëria dhe Perceptimet; ISN 2012; fq 21


Në përgjithësi, a mendoni se Shqipëria po ecën në drejtimin e duhur?



Përgjithësisht, a mendoni se demokracia shqiptare po shkon në drejtimin e duhur apo në drejtimin e gabuar?



Ky rezultat duhet të shihet si shtesë e përgjigjes të një pyetjeje tjetër e cila iu kërkonte qytetarëve të përshkruanin gjendjen demokratike aktuale të Shqipërisë.



Shumica e të anketuarve, 36 për qind, mendojnë se situata në Shqipëri është më shumë jo demokratike sesa demokratike, dhe një numër i konsiderueshëm prej 23 për qind, 1/3 e atyre që janë përgjigjur, besojnë se Shqipëria është një vend plotësisht jo demokratik. 21 për qind e atyre që janë përgjigjur besojnë se Shqipëria është më shumë demokratike se e kundërta, ndërsa vetëm 11 për qind besojnë se vendi i tyre është një demokraci e plotë. Krahasuar me vitin e kaluar, numri i atyre që pretendojnë se Shqipëria është tërësisht jo demokratike ose disi jodemokratike është më të lartë.⁹ Nisur nga këto dy pyetje, në perceptimin e qytetarëve, gjendja e demokracisë shqiptare është jo e shëndetshme dhe e ardhmja e saj e pasigurt.


⁹ Vetëm 16 për qind e të intervistuarve vitin e kaluar thanë që Shqipëria ishte tërësisht jo demokratike dhe numri i atyre që thanë se është më shumë jo demokratike se demokratike ishte pothuaj I njëjtë më ata që thonin të kundërtën (33 për qind dhe 32 për qind). Shqipëria në dhejtë vitet e ardhshme: Politika, Ekonomia, Shogëria dhe Perceptimet; ISN 2012; fq 37.

Një situatë më e zymtë paraqitet për sa i përket perceptimit të qytetarëve për ekonominë. Një pjesë e madhe e tyre, më shumë se 63%, besojnë se ekonomia Shqiptarë është në rrugën e gabuar, ndërsa vetëm 23 për qind besojnë së po shkon në drejtimin e duhur. Përsëri, pak më shumë se 1/10 e atyre që janë pyetur refuzojnë të përgjigjen.

SFIDAT E DEMOKRACISË

Të pyetur për problemet kryesore që ndikojnë në funksionimin e demokracisë në Shqipëri sot, shumica e qytetarëve ose 29 për qind, besojnë se ndikim ka mungesa e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, të ndjekur nga një tjetër 23 për qind, të cilët zgjedhin konfliktin politik. Një pjesë e konsiderueshme e atyre që janë përgjigjur, 13 për qind, për secilin opsion, përmendin mungesën e ndryshimit të lidershit politik, si edhe diferenca të mëdha në statusin ekonomik të qytetarëve (hendeku midis të pasurve dhe të varfërve). 8 për qind besojnë së e shkuara komuniste është ende një pengesë për demokracinë shqiptare, ndërsa një grup shumë i vogël njerëzish, rreth 5 për qind, duket se janë të shqetësuar për gjendjen e të drejtave të njeriut, si dhe ngadalësimin e procesit të integrimit evropian.

Për sa i përket përcaktimit të faktorëve, të cilët luajnë rolin më të rëndësishëm në funksionimin e demokracisë në Shqipëri, një pjesë e qytetarëve shqiptarë ose 26 për qind, zgjedhin rolin e qeverisë, të ndjekur nga 23 për qind të cilët zgjedhin udhëheqjen politike, kurse 22 për qind që thonë “qytetarët”. Komuniteti ndërkombëtar shihet si një aktor primar në funksionimin e demokracisë prej 14 për qind të qytetarëve ndërsa media dhe shoqëria civile marrin rezultate modeste prej respektivisht 6 dhe 4 për qind secila. Duket sikur ka një qasje më normale për sa i përket rolit të komunitetit ndërkombëtar vis-à-vis demokracisë në Shqipëri duke qenë se shqiptarët vitin e kaluar u përgjigjën në numra shumë më të mëdhenj, rreth 30




për qind, duke zgjedhur komunitetin ndërkombëtar si faktorin kryesor për demokracinë. Nga ana tjetër, këtë vit duket sikur ka më tepër vlerësimi për rolin e qeverisë dhe lidërshiptit politik.¹⁰

BESIMI HORIZONTAL

Çdo herë e më shumë, sondazhet dhe studimet tregojnë se shqiptarët kanë nivele shumë të ulëta besimi te institucionet si dhe përfaqësuesit e tyre politikë. Edhe në këtë sondazh tregohen nivele mjaft të ulëta për sa i përket partive politike, gjykatave në Shqipëri, qeverisë, Kryeministrit apo Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me një skepticizëm në rritje edhe mbi ata aktorë të cilëve u besohej pak më shumë më përpara, siç janë media apo institucionet fetare.

Në prag të zgjedhjeve, 48 për qind e shqiptarëve nuk iu besojnë fare partive politike, të ndjekur nga 29 për qind të

¹⁰ Shiko rezultatet në Tabelën 21 tek Shqipëria në dhejtë vitet e ardhmë: Politika, Ekonomia, Shoqëria dhe Perceptimet; ISN 2012; fq 38.



cilët iu besojnë atyre pak. Ky rezultat është i çuditshëm po të konsiderojmë numrin e lartë të votuesve dhe polarizimin në rritje të shoqërisë shqiptare sipas linjave partiake.

45 për qind e të intervistuarve thonë se ata nuk iu besojnë aspak gjykatave në Shqipëri, duke reflektuar kështu një zhgënjim të kahershëm me sistemin gjyqësor në Shqipëri.¹¹ 25 për qind e qytetarëve u besojnë gjykatave ndërsa 20 për qind u besojnë disi.

Të njëjtat numra rezultojnë edhe për kryeministrin të cilin 45 për qind e qytetarëve nuk e besojnë aspak, të ndjekur nga 19 për qind të cilët e besojnë pak. Gjithsesi, 33 për qind e qytetarëve i besojnë kryeministrit disi ose plotësisht.

Një skepticizëm i madh ekziston edhe për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ). 43 për qind e të anketuarve nuk kanë asnjë lloj besimin në këtë institucion, të ndjekur nga 22 për qind të cilët kanë pak besim. Vetëm 30 për qind e të

¹¹ Vitin e kaluar në një sondazh të kryer nga ISN, 64 për qind e qytetarëve thanë se kishin zero ose shumë pak besim në sistemin gjyqësor, të ndjekur nga 24 për qind të cilët kishin disi besim. Shqipëria në dhejtë vitet e ardhshme: Politika, Ekonomia, Shoqëria dhe Perceptimet; ISN 2012; fq 28

intervistuarve kanë një farë besimi te KQZ dhe prej tyre vetëm 9 për qind kanë besim të plotë. Vetë struktura e anëtarëve të KQZ, të cilat janë të caktuar vetëm nga partitë dhe mbajnë një qëndrim krejtësisht të polarizuar, si dhe puna e KQZ në proceset e kaluara elektorale me sa duket e kanë gërryer jashtëzakonisht besimin e publikut të KQZ. Duke qenë spektatorë të odiseve të lodhshme të konfliktit dhe tendencave të votimit sipas linjave partiake, si dhe të bllokimit të punës së këtij institucioni, të anketuarit tregojnë një nivel të lartë skepticizmi mbi aftësinë e KQZ për të luajtur rolin e tij në një mënyrë profesionale.


Vetëm 31 për qind e të anketuarve kanë disi ose plotësisht besim te qeveria, kurse 43 për qind e tyre nuk i besojnë qeverisë, ndërsa 24 për qind i besojnë pak.

Duket se ka një rënie të besimit rreth Presidentit të Republikës pasi 41 për qind e qytetarëve nuk besojnë te Presidenti, të ndjekur nga 22 për qind të cilët i besojnë pak. Megjithatë, 34 për qind e qytetarëve kanë besim te Presidenti.¹²

Mungesë besimi ka edhe te opozita politike me 34 për qind të të anketuarve që nuk kanë aspak besim te ajo, të ndjekur nga 28 për qind që kanë pak besim.

Megjithëse rezultatet për sa i përket policisë shqiptare, Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm, medias dhe institucioneve fetare janë më pozitive, skepticizmi ekziston edhe për ta. Me 51 për qind të qytetarëve që kanë besim te media, ky aktor ruan pozicionin e privilegjuar, paçka se më të lëkundur së më përpara, për sa i përket besimit të qytetarëve. 23 për qind kanë thënë se nuk i besojnë fare medias, duke dhënë një rezultat kaq të lartë për herë të parë, gjë që reflekton një zhgënjim me mediat që tregohen të njëanshme dhe humbasin pavarësinë për shkak të biznesit dhe interesave politike.

¹² Vetëm 16 për qind të qytetarëve vitin e kaluar (përpara zgjedhjes së Presidentit të ri) raportuan për zero besim në figurën e Presidentit të ndjekur nga 35 për qind të cilët kishin pak besim, dhe një mazhorancë të theksuar 53 për qind të cilët kishin disi besim apo besim të plotë. Shqipëria në dhejtë vitet e ardhshme: Politika, Ekonomia, Shogëria dhe Perceptimet; ISN 2012; fq 28.



Vlerësime kontradiktore jepen nga qytetarët Shqiptarë edhe për shoqërinë civile. 47 për qind e të anketuarve thonë se ky është një aktor te i cili besojnë, plotësisht (15 për qind) ose pjesërisht (32 për qind), kurse 49 për qind e tyre shprehin ose pak besim (26 qind) ose asnjë lloj besimi (23 për qind).

MARRËDHËNIET NDËRKOMBËTARE DHE POLITIKA E JASHTME

Shqiptarët duken të ndarë për sa iu përket vendeve që kanë pasur një ndikim të madh te Shqipëria. 22 për qind mendojnë se nuk ka pasur asnjë ndikim asnjë vend tjetër, ndërsa 27 për qind refuzojnë të përgjigjen. Megjithatë, 51 % mendojnë se ka pasur padyshim ndikim dhe shumica dërrmuese e tyre ose 79

për qind mendojnë se ky vend ka qenë Shtete e Bashkuara të Amerikës. Vetëm 6.8 për qind besojnë se ndikimi është ushtruar nga BE i ndjekur nga raste të tjera të cilat janë statistikisht të parëndësishme.

Kur vjen puna për të vlerësuar vendet potenciale, që mund të përbëjnë rrezik për Shqipërinë, të intervistuarit këtë herë janë të ndarë në tre kategori të ngjashme, me 1/3 që beson se nuk ka ndonjë kërcënim dhe 1/3 që thonë se nuk e dinë. Nga 32 për qind që mendojnë se ka një rrezik, shumica prej 55.8 për qind besojnë se ky rrezik vjen nga Greqia, kurse 24.3 për qind mendojnë se ky rrezik vjen nga Serbia. Vendet e tjera të përmendura nuk kanë vlera të përfillshme statistikore.


Për sa i përket faktit se çfarë duhet të bëjë Shqipëria për të intensifikuar bashkëpunimin rajonal dhe se te cilat vende duhet të investojë veçanërisht, përgjigjet reflektojnë tendencat që janë vërejtur në të kaluarën. Kosova qëndron në krye të listës së prioriteteve sipas 63 për qind të shqiptarëve, të cilët besojnë se qeveria duhet të tregojë kujdesin maksimal për të forcuar bashkëpunimin me këtë vend, i ndjekur nga Turqia për të cilën 59 për qind besojnë të njëjtën gjë. Duket se ka një rënie të lehtë prej vitit të kaluar, ku më shumë qytetarë mendonin se Shqipëria duhet të fuqizonte marrëdhëniet dhe bashkëpunimin me Kosovën, rreth 76 për qind.¹³

1/3 e atyre që janë përgjigjur besojnë se një vëmendje e tillë maksimale duhet t'i kushtohet marrëdhënieve me Greqinë, Maqedoninë, Malin e Zi dhe Kroacinë. Shqiptarët duken më pak të interesuar në fuqizimin e bashkëpunimit me Serbinë dhe Bosnjën dhe Hercegovinën, me respektivisht përqindjen më të lartë të atyre që thonë se qeveria nuk duhet të harxhojë kohë duke intensifikuar bashkëpunimin me këto vende: përkatësisht 46 për qind për Serbinë dhe 33 për qind për Bosnjë & Hercegovinën.

13 *Perspektiva Europiane e Shqipërisë: Perceptime dhe Realitete 2012.* ISBN: 2012, fq 37

KOSOVA


Për gjysmën e shqiptarëve të intervistuar, bashkimi i mundshëm me Kosovën është një gjë pozitive, të ndjekur nga pothuaj 1/3 të cilët thonë se nuk është një zhvillim as pozitiv dhe as negativ. Vetëm 10 për qind e të intervistuarve e shikojnë këtë si diçka negative, ndërsa një grup i ngjashëm prej 12 për qind, nuk përgjigjet. Vlerësimi i kësaj mundësie duket të jetë relativisht konsistent me atë të dhënë vitin e kaluar kur 59 për qind e të intervistuarve e konsideronin një zhvillim pozitiv ndërsa 11 për qind e konsideronin negativ. Megjithatë, këtë vit duket se ka një rritje në radhët e atyre që e përshkruajnë këtë gjë si neutrale, që do të thotë as negative e as pozitive.¹⁴



Nëse me të vërtetë do të kishte një referendum mbi bashkimin e Shqipërisë dhe Kosovës në një shtet të vetëm, 55 për qind të shqiptarëve do të votonin pro, ndërsa 14 për qind do të votonin kundër. Një grup prej 16 për qind nuk do të merrnin pjesë duke mos votuar fare në këtë referendum. Në votën pro, e cila vitin e kaluar ishte 62 për qind, ka pasur një rënie të lehtë me më shumë njerëz të cilët këtë vit zgjedhin për të abstenuar.¹⁵


¹⁴ Shqipëria në dhjetë vitet e ardhshme: Politika, Ekonomia, Shqipëria - Perceptime. ISN 2012; fq 52

¹⁵ Vetëm 10 për qind të të intervistuarve të pyetur 1 vit më parë, thanë se do të abstenuonin në një referendum të tillë. Shqipëria në dhjetë vitet e ardhshme: Politika, Ekonomia, Shqipëria - Perceptime. ISN 2012; fq 51




KARAKTERISTIKAT E KAMPIONIT


Për këtë sondazh u intervistuan 1200 qytetarë, të ndarë në mënyrë të barabartë midis 51 % femrave dhe 49 % meshkujve.



Grupmoshat e ndryshme janë përfaqësuar me shumicën e të intervistuarve që futen në kategorinë midis 18-30 vjeç. Një e treta e të intervistuarve janë midis 18 dhe 29 vjeç, të ndjekur nga 1/3 të cilët i përkasin grupmoshës 30-39 vjeç. 18 për qind janë midis 50-69 vjeç, ndërsa 19 për qind janë midis 40-49 vjeç. Vetëm 4 për qind e kampionit është i përbërë nga njerëz mbi 70 vjeç.



Për sa i përket arsimimit, 38 për qind e kampionit përbëhet nga njerëz me arsim të mesëm, ndërsa 31 për qind janë të diplomuar në universitete. 6 për qind janë në proces ose kanë përfunduar studimet pas universitare, ndërsa 25 për qind ose nuk kanë arsimim zyrtar ose kanë përfunduar thjesht arsimin fillor.



Duke konsideruar situatën e punësimit të të intervistuarve tanë, 37 për qind raportojnë se janë të punësuar, ndërsa 23 për qind janë të papunë. 7 për qind e kampionit përbëhet nga pensionistë, ndërsa 16 për qind e tyre janë studentë. 16 për qind e të intervistuarve janë të vetëpunësuar përfshi dhe shtëpiaket në këtë kategori.

